



NË KËTË NUMËR:

Numri #1 (Nëntor 2010)

- Parathënie nga Ekipi Redaktues
- Fëmijët në mbrojtje të mjedisit
- Grumbullimi i mbeturinave dhe pastrimi në fshatin Lubovishtë
- Klubet për mjedis dhe energji në shkolla fillore
- U nënshkrua memorandumi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në mes të AMMK-së dhe BELLS Kosova
- U gjet fosili i luleshqerrës i vjetër 50 milion vjet
- Barka e parë me energji diellore fillon udhëtimin e parë

KY BULETIN ËSHTË SHTYPUR NË LETËR TË RICIKLUAR

## PARATHËNIE

I Nderuari Lexues,

Në dorë mbani numrin e parë të buletinit informativ mjedisor. Botimi i këtij buletini është kontribut i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Nevoja për të ngritur nivelin e informimit cilësor rreth mjedisit në Kosovë ka qenë një nga arsytet që nxiti botimin e këtij buletini që do të bëhet në bazë tremujore. Qëllimi kryesor i këtij botimi është që të sjellim para jush informata të rëndësishme rreth mjedisit, por edhe të pasqyrojmë zotimin, përpjekjet dhe aktivitetet e institucioneve mjedisore, organizatave joqeveritare dhe nismave qytetare për përmirësimin e kushteve mjedisore.

Në faqet në vijim do të gjeni këshilla të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit, kuriozitet mjedisore, kalendarin e ngjarjeve mjedisore botërore si dhe fakte të rëndësishme mjedisore. Shfrytëzojmë rastin që të ftojme të gjithë individët dhe organizatat e interesuara që të bashkëpunojnë me ne duke na dërguar informacione rreth aktiviteteve mjedisore me qëllim të përmbushjes së synimit tonë. Shpresojmë se me bashkëpunim të frytshëm dhe zotim të përbashkët, ky buletin do të bëhet një burim tjetër për t'ju ofruar informata të përditësuara dhe interesante rreth gjendjes së mjedisit që na rrethon.


Ekipi Redaktues

\*\*\*\*\*


## LAJME NGA VENDI

### Fëmijët në mbrojtje të mjedisit

Në kuadër të projektit "Fëmijët në Mbrojtje të Mjedisit", Advocacy Training and Resource Center (ATRC) ka shpërndarë 60 grante për 60 shkolla fillore në 30 komunitet në Kosovë. Granti në vlerë prej 180e, kishte për qëllim vetëdijësimin e fëmijëve për ruajtjen e mjedisit, përkatësisht mbrojtjen e ambientit ku ata mësojnë.



Në kuadër të këtij projekti u mbollën fidane, lule, pisha; pastaj dherat u shndërruan në kopshte gjelbëruese, u vendosën ulëse për nxënës, shporta për hedhurina, e shumë aktivitete të tjera. Projektet janë udhëhequr nga grupi i Ambasadorëve të Vegjël të Mjedisit," të cilët kohë më parë u certifikun si të tillë nga kjo organizatë.



## **FAKTE**

### **KRYESORE**

- Ndotësit kryesor të ajrit në Kosovë janë prodhimi i energjisë, sektori i transportit dhe prodhimi industrial
- Kohëve të fundit, organizatat e shoqërisë civile janë bërë më aktive dhe më të organizuara në mbrojtje të mjedisit
- Krijimi i mbeturinave paraqet një nga shqetësimet më të mëdha mjedisore, përveç se është barrë ekonomike për shoqërinë e Kosovës
- Një burim i madh i ndotjes me mbeturina është shkarkimi i ujërave të patrajtuara të zeza në rrjedhat lokale të ujit
- Tani për tani, rreth 75% e popullsisë ka qasje në shërbimet e ujësjellësit, përderisa vetëm 55% e popullsisë ka qasje në rrjetin e kanalizimit

Muharrem Ahmetaj, drejtor i Shkollës Fillore "Idriz Seferi" - Bob, Kaçanik, vlerëson se ky projekt ishte shumë i mirëseardhur duke marrë parasysh edhe qëllimin.

"Edhe pse me mjete modeste, rëndësia e tij ka qenë e veçantë, sepse i kemi angazhuar nxënësit së bashku me arsimtarët në aktivitet; nxënësit u motivuan për të ruajtur, klasat, shkollën, ambientin e kështu me radhë."



Z. Ahmetaj konsideron se e veçantë tjetër e këtij projekti ishte edhe angazhimi i KFOR-it Amerikan, i cili njëkohësisht iu bashkangjiti aktivitetit duke inkurajuar nxënësit e angazhuar si dhe ofroi ushqim dhe pije gjatë kësaj kohe.

Poashtu, 100 kilometra larg Fshatit Bob të Kaçanikut, në fshatin Batllavë të Podujevës, ky projekt ishte i mirëpritur. "Kjo është një ndihmesë mjaft e mirë dhe domethënëse për shkollën, sepse përveç që shkolla mori një pamje më të bukur dhe më të pastër, njëkohësisht nxënësit u motivuan dukshëm për mirëmbajtjen e këtij ambienti edhe në të ardhmen" - thotë Nazmie Hyseni, arsimtare në Shkollën Fillore "Luigj Gurakuqi" në Batllavë të Podujevës. .

Projekti për mbrojtjen e mjedisit do të vazhdojë edhe më tutje dhe po mbështetet nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. □

## **Grumbullimi i mbeturinave dhe pastrimi në fshatin Lubovishtë**

Për disa vite me radhë, banorët e fshatit Lubovishtë afër Dragashit nuk kanë pasur qasje në shërbimin e grumbullimit të rregullt të mbeturinave.

Si rrjedhojë, mbeturinat hidheshin në të dyja anët e përrorskës që rrjedh nëpër fshat. Me kohë, mbeturinat e hedhura filluan të lirojnë erë të pakëndshme, të joshin brejtësit dhe insektet, dhe të ndotin ujin e përrorskës, duke rrezikuar shëndetin publik dhe degradimin mjedisor. Fshatarët e Lubovishtës filluan të bëjnë thirrje për ndryshim.



Mbeturinat e hedhura në breg mbi përrorskë para pastrimit

"Grumbullimi i mbeturinave dhe pastrimi në fshatin Lubovishtë" është një nga projektet provuese të zbatuara në Dragash nga UNDP-ja dhe i financuar nga Qeveria e Finlandës, që adreson sfidat e menaxhimit të mbeturinave në komunë. Aktivitetet përfshinë pastrimin e dy deponive të mbeturinave dhe krijimin e një sistemi funksional të grumbullimit të mbeturinave.

Largimi i mbeturinave nga dy brigjet afër përrorskës zgjati rreth tre javë. Deponia kryesore, e vendosur në qendër të fshatit, u rrethua me shtylla dhe rrjetë metali nga fshatarët. U dakordua që të ndalohet hedhja e mbeturinave në këtë deponi.

Kjo marrëveshje është respektuar plotësisht nga fshatarët gjatë 6 muajve të fundit. Ka filluar bashkëpunimi me një kompani lokale për grumbullim të mbeturinave, dhe mbeturinat grumbullohen derë-më-derë çdo të shtunë, dhe shërbimi paguhet nga fshatarët.

### **SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT**

Fshiji shtigjet, mos i laj me ujë të pijshëm



Mundohu që automjetin ta lashë më rrallë



Gjithmonë fiki dritat kur del nga dhoma





## Kalendari mjedisor

6 nëntor 2010

Dita ndërkombëtare për parandalimin e eksploatimit të mjedisit në luftë dhe në konflikt të armatosur

[http://www.un.org/Depts/dhl/environment\\_war/ind\\_ex.html](http://www.un.org/Depts/dhl/environment_war/ind_ex.html)

27 nëntor 2010

Dita ndërkombëtare për të mos blerë

<https://www.adbusters.org/campaigns/bnd>

2 dhjetor 2010

Shpërblimet globale të gjelbra

[http://greenawards.co.uk/categories/x\\_16/green\\_awards\\_2010](http://greenawards.co.uk/categories/x_16/green_awards_2010)

11 dhjetor 2010

Dita ndërkombëtare e maleve

[http://www.fao.org/mnts/intl\\_mountain\\_day\\_en.asp](http://www.fao.org/mnts/intl_mountain_day_en.asp)



Bregu pas pastrimit

Lubovishta është fshati i parë prej 16 fshatrave në rajonin e Gorës që është përfshirë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Fshatarët janë të kënaqur pasi që të dy deponitë tani janë të pastra. Ndërkohë, disa fshatra të afërta gorane gjithashtu kanë kërkuar nga UNDP-ja mbështetje që të zgjidhin telashet e tyre në menaxhimin e mbeturinave. Ky duhet të konsiderohet si ndikim pozitiv rajonal i projektit. □

## Klubet për mjedis dhe energji në shkolla fillore

Klubi Kosovar për Energji & Mjedis (KKEM) i krijuar në shtator të vitit 2009, synon ngritjen e vetëdijes për çështjet mjedisore nëpër shkollat fillore në Kosovë. "Misioni ynë është të promovojmë qëndrueshmëri afatgjatë të energjisë dhe mjedisit në Kosovë duke edukuar dhe ngritur vetëdijen në mesin e gjeneratave të reja mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, përfshirë shfrytëzimin racional dhe efikas të energjisë në jetën e përditshme", thotë znj. Arbresha Meha, Drejtoreshë e KKEM-it.

Në maj të vitit 2010, projekti në vazhdim e sipër "Mbështetja për krijimin e klubeve për mjedis dhe energji në shkollat fillore brenda Kosovës", i financuar nga Ambasada e ShBA-së, ka mbajtur punëtori në tri shkolla fillore në Prishtinë: Hilmi Rakovica, Hasan Prishtina dhe 7 Marsi. Në këto shkolla është bërë vlerësimi i mundësive të përfshirjes së çështjeve mjedisore dhe të energjisë në planprogramin arsimor në nivel fillor dhe të mesëm.

Ligjëratat, diskutimet grupore dhe aktivitetet praktike për tema të ndryshme që lidhen me mbrojtjen mjedisore, ngritin nivelet e dijes dhe të kuptimit për ndërlidhje të mjedisit me jetën e përditshme.

Përveç kësaj, është me rëndësi mësimi praktik që përforcon aftësitë e nxënësve për zgjidhje të problemeve nëpërmjet punës grupore dhe aktivizmit në shkollë. "Kemi vërejtur se për nxënësit është interesante dhe emocionuese kur mësojnë për këto çështje. Kjo i mundëson ata që të përfitojnë aftësi për mënyrën se si të adresojnë çështjet që janë të rëndësishme për komunitetin më të gjerë", thotë znj. Meha. □



Nxënësit e shkollës fillore në klubin për energji & mjedis

*Ndihmo kursimin e energjisë dhe mjedisit duke reduktuar konsumin e rrymës elektrike.*





## U nënshkrua memorandumi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në mes të AMMK-së dhe BELLS Kosova

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Lëvizja Mjedisore Rajonale BELLS Kosova, kanë nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit. Përmes nënshkrimit të këtij memorandumi këto dy institucione dakordohen që të rrisin përpjekjet dhe angazhimet e përbashkëta në funksion të implementimit të politikave publike, gjithmonë duke u bazuar në vlerësime paraprake mjedisore.



Z. Ilir Morina, Shef i AMMK-së (në të djathtë) duke nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me z. Kushtrim Kaloshin, Koordinator për Kosovë i lëvizjes BELLS

Të dy palët nënshkruese të këtij dokumenti pajtohen që të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet e përbashkëta në çështje të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, përmes procesit të ashtuquajtur "Diplomacia e gjelbër" nëpërmes të cilit do të ndikohet në rritjen e numrit të qytetarëve të angazhuar në çështje të mjedisit në përgjithësi, dhe zhvillimit të përgjithshëm në nivel lokal dhe nacional në veçanti.

Subjekti i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është i lidhur ngushtë edhe me pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta në zbatimin e një fushate të gjerë ndërgjegjësuese dhe informuese për qytetarët e Kosovës në lidhje me mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes në mjedis duke i motivuar ata që angazhimi në dhe rreth çështjeve mjedisore të jetë i vazhdueshëm dhe i bazuar në çështje konkrete.

Memorandumi në mes tjerash parasheh edhe angazhimin që çështja e mjedisit, të jetë pjesë e pandashme dhe e vazhdueshme në gjithë procesin e politik bërjes në nivelet nacionale dhe lokale, mbështetjen e iniciativave të gjelbra në interes të përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës, përkrahjen e aktiviteteve të OJQ-ve të përqendruara në çështje të mjedisit, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndër- komunal, rajonal dhe ndërkufitarë. □

### LAJME NGA BOTA

Për numrin e radhës 2/2011, abonohu në : <http://www.ks.undp.org>

Ky buletin botohet në bashkëpunim me Ministrinë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Ekipi redaktues: Afrim Berisha (MMPH), Rizah Hajdari (MMPH), Nadia Chaichee (UNDP) dhe Burbuqe Dobranja (UNDP).

## U gjet fosili i luleshqerrës i vjetër 50 milion vjet

Një fosil i vjetër 50 milion vjet i lules që i përket familjes Asteraceae (siç është luleshqerra, luledielli), u gjet në Patagoni, në anën e Argjentinës. Zbulimi i rrallë, lulja fosile, tani ka hapur rrugën për teori të shumta për ekzistencën e luleve para shumë e shumë vitesh. Është jashtëzakonisht e rrallë që të gjendet një mostër aq mirë e ruajtur e florës nga një kohë aq e largët. Shumica e fosileve lule që gjenden nga paleobotanikët janë grimca poleni. Ky lajm gjeti vend në revistën prestigjioze "Science" (Shkenca). □

## Barka me energji diellore fillon udhëtimin e parë

*Turanor Planet Solar*, anija më e madhe në botë me energji diellore, ka filluar turneun botëror nga Monte Carlo. Qëllimi i këtij udhëtimi është zgjerimi i dijes mbi energjinë diellore dhe përfitimet nga ajo në tërë botën. Anija është e gjatë 31 metra, e lartë 15 metra dhe gjithsej ka 537 metra katror sipërfaqe. Udhëtimi nëpër botë do të zgjas rreth tetë muaj dhe do të vizitohet brigjet perëndimore dhe lindore të Amerikës veriore, Meksikos, Australisë, Singaporit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe. Themeluesi i projektit, Raphel Domjan, 37 vjeç, është pjesë e ekuipazhit gjashtë anëtarësh. Emri Turanor vjen nga Singapori, që do të thotë "fuqia e diellit". □

### SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT

Përdor çanta pëlhure në vend të qeseve të plastikës kur bën pazar



Ndale ujin e rubinetit kur lan dhëmbët



Hedh mbeturinat në shportë e jo në mjedis

